

Intelegjenca nën lupë¹

Nga Arber Ahmeti-Prishtine

Duke parë zhvillimet e fundit në Kosovë, siç janë krijimi i organeve të sigurisë, më konkretisht Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe Agjencisë Kosovare të Intelgjencës (AKI), krijojmë përshtypjen se ne po hecim me hapa të sigurt drejt shtetformimit. Por nëse kridhemi më thellë dhe shikojmë se si dhe për çka janë krijuar këto organe, kuptojmë se ato janë mutacion i atyre të vërtetave.²

Për rastin e FSK-së tanimë është folur dhe madje edhe është pohuar edhe nga vetë zyrtarët e NATO-s dhe komandantët e KFOR-it që roli i saj është thjesht i një Force të Mbrojtjes Civile, dhe se FSK-ja nuk është ushtri. Mirëpo shumë pak është thënë për Agjencinë Kosovare të Intelgjencës, ndoshta për shkak të natyrës së saj, apo ndoshta për të fshehur qenien e saj larg një shërbimi informativ të mirëfilltë. Për të zbuluar natyrën e këtij organi shumë të rëndësishëm shtetëror, duhet të kthehemi atje ku e ka zanafillën ajo, pra tek Plani i Ahtisaar-it.

Aneksi VIII, neni 4.1 i Planit të Ahtisaar-it thotë: "*Kosova do të themelojë një agjencion vendor të sigurisë për të mbikëqyrur kërcënimet ndaj sigurisë së brendshme të Kosovës në përputhshmëri me Aneksin IX. Ky agjencion do të jetë profesional, apolitik, shumëetnik dhe nën mbikëqyrje të parlamentit dhe administratës civile.*"

Ky nen që flet për formimin e agjencisë informative, është i shkurtë dhe nuk është i mbushur plot me kufizime dhe detyrime siç ndodh tek pjesa që flet për krijimin e FSK-së, ama rrengu qëndron tek fakti që i tërë theksi vihet që themelimi i Agjencisë së Intelgjencës të bëhet në përputhje me Aneksin IX. Pra le ta zbërthejmë Aneksin IX në përputhje me të cilin duhet të jetë krijimi i kësaj agjencie.

Aneksi IX i Planit të Ahtisaar-it dikton se "*PCN mund të marrë masa korigjuese për të përmirësuar çdo veprim nga autoritetet e Kosovës*", e mandej thuhet se "*masa të tilla korigjuese mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në anulimin e ligjeve dhe vendimeve që miratohen nga autoritetet e Kosovës*".

Kjo do të thotë që do të monitorohet edhe AKI, gjë që na e vërtetojnë edhe nenet që do i cekim në vijim, dhe puna e veprimet e AKI-së do të mbikëqyren dhe kontrollohen plotësisht nga dikush që nuk është Presidenti, Kryeministri apo Komisioni për Mbikëqyrje Parlamentare, por do të jetë Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar (PCN), që e ka emrin Pieter Feith.

¹ Opinionet e autorit nuk përfaqesojne domosdoshmërisht qëndrimin e QSHSSK për këtë problem.

² Shkrimi është botuar me datën 09.03.2009 në Gazetën "Vetevendosje"

Po ashtu PCN, sipas nenit 2.1 (d) mund të "sanksionojë apo largojë nga detyra çdo zyrtar publik apo të ndërmarrë masa të tjera". Sipas kësaj PCN mund të largojë edhe të punësuarit në AKI, edhe pse nuk konsiderohen punonjës civil. Neni 2.3 (f) i jep të drejtën PCN-së apo Përfaqësuesit Special i BE-së (përcaktohet në Aneksin IX se këto dy funksione ushtrohen nga i njëjti person) që t'i "anulojë vendimet operative që merren nga autoritetet e Kosovës për të garantuar ruajtjen dhe promovimin e sundimit të ligjit, rendit publik dhe sigurisë".

Nga kjo nënkuptohet që çdo nismë e AKI-së për të mbikëqyrur dikënd apo mledhur informacion dikund për një gjë të caktuar, mund të anulohet nëse Pieter Feith-it (Zyres Civile Ndërkombëtare) nuk i konvenon kjo gjë.

Monitorimi i AKI-së dhe veprimtarisë së saj vërtetohet edhe nga pika (g) e po këtij neni (Aneksi IX, neni 2.3), ku thuhet se institucionet e Kosovës obligohen të "ofrojnë qasje të menjëhershme dhe të plotë tek çdo vend, individ, veprimtari, procedurë, dokument apo çështje a ngjarje tjetër në Kosovë".

Pra kjo pike e po këtij neni është më e dëmshme, për shkak se Qeveria e Kosovës obligohet të ndajë çdo informacion dhe ta marrë vizën për çdo veprim të vetin nga dikush që nuk është përfaqësues i popullit të Kosovës, pra nga Pieter Feith-i. Në nenin 2.5 (Aneksi IX) thuhet se PCN-ja do të mbikëqyrë zhvillimin e agjencisë vendore të sigurisë, siç është përcaktuar në Aneksin VIII të Planit të Ahtisaar-it), dhe kjo mbikëqyrje përfshinë edhe kompetencat të cilat u cekën më sipër.

Pra Plani i Ahtisaar-it ka bërë një lojë qëllimisht të përshtjelluar, ku kufizimet dhe mbikëqyrja e tmerrshme nuk ceken në nenin kushtuar Agjencisë së Intelgjencës, por në një Aneks krejt tjetër.

Në anën tjetër, ligji për AKI i aprovuar në Kuvendin e Kosovës dhe i përpiluar në harmoni me Planin e Ahtisarit gjë që Kushtetuta e Kosovës e obligon në nenin 143.3, në nenin 2.1 të këtij ligji ku përcaktohen detyrat e AKI, ndër të tjera thuhet: "AKI mbledh informacion në lidhje me kërcënimet ndaj... rendit kushtetues...", që do të thotë se secili që kundërshton dhe proteston Planin e Ahtisaar-it, e cila e imponon Kushtetutën e Kosovës dhe ligjet që dalin prej saj, kërcënon rendin kushtetues të Kosovës.

Nga të tri postet më të larta të AKI-së, që janë Drejtori, Zv.Drejtori dhe Inspektori i Përgjithshëm, duke u bazuar nga parimi i multietnicitetit i cekur në nenin 129.2 të Kushtetutës së Kosovës, sigurisht që njëri do t'i takojë një anëtar nga komunitetet, përkatësisht një serbi, i cili nuk do ta konsiderojë veten si punëtor i Kosovës, por si i infiltruar aty, meqë strukturat paralele serbe nuk janë shpërbërë, dhe prandaj ato ushtrojnë një kontroll të drejtpërdrejtë mbi të gjithë ata që ia mësyjnë institucioneve, dhe ky konstatim mund të mbështetet me mënyrën e veprimit të punëtorëve serbë të ShPK-së pas shpalljes së pavarësisë në bazë të Pakos së Ahtisaar-it më 17 shkurt 2008.

Nga kjo vijmë në përfundimet se AKI nuk do t'i raportojë vetëm Kryeministrit dhe Presidentit, siç thotë Kushtetuta, por edhe PCN-së, Pieter Feith.

Po ashtu nga shtjellimet e mësipërme kuptojmë se AKI nuk do të ketë vetëm mbikëqyrje parlamentare, por do të kontrollohet dhe mbikëqyret tërësisht nga PCN, përderisa e tërë kjo na shpie tek përfundimi që këto organe të sigurisë qëndojnë larg së qenuri organe të mirëfillta të sigurisë sikur në shtetet normale.